

Reforma policore dhe gjinia

PËRMBAJTJA

Pse është gjinia e rëndësishme për reformën policore?

Si mundet të integrohet gjinia në reformat policore?

Sfidat dhe mundësitë e pas-konfliktit

Pyetje për reformën policore

Informata më të hollësishme

Ekziston një përkrahje e fuqishme e konceptit që reforma e sigurisë (RSS) duhet të përbushë nevojat e posaçme të burrave, grave, djemve dhe vajzave. Integrimi i çështjes së gjinive poashtu është kyç për efektivitetin dhe përgjegjësinë e sektorit të sigurimit si dhe për zotërimin dhe legjitimitetin lokal të SSR proceseve.

Ky shënim praktik siguron prezantim praktik të dobive nga integrimi i çështjes së gjinive në brenda reformës policore si dhe informata praktike se si duhet bërë kjo.

Shënim praktik është i bazuar në një vegël më të zgjëruar, dhe të dyjat janë pjesë e **Doracakut të gjinive dhe SSR**. I disenjuar për furnizimin dhe prezantimin e çështjeve të gjinive për SSR praktikentët dhe krijuesit e politikës vepruese, ky doracak përbën 12 vegla me shënime praktike (ushtrime) korresponduese – shiko në Më tepër informata..

Pse është gjinia e rëndësishme për reformën policore?

Reforma policore paraqet transformim ose ndryshim të organizatës policore në një shërbim policor profesional dhe të besueshëm që ushtron stilin e veprimit që u përgjigjet nevojave të komuniteteve lokal¹.

Gjinia ka të bëjë me rolin dhe raportet, veçorive të personalitetit, qëndrimeve, sjelljeve dhe vlerave që shoqëria u a ngjet burrave dhe grave. 'Gjinia' pra, ka të bëjë me diferencat e mësuara ndërmjet burrave dhe grave, ndërsa 'seksi' ka të bëjë me diferencat biologjike ndërmjet meshkujve dhe femrave. Rolet e gjinive ndryshojnë plotësisht brenda një kulture apo midis kulturave të ndryshme dhe mund të ndryshohen gjatë kohës. Gjinia nuk ka të bëjë thjeshtë vetëm e burrat dhe gratë por edhe me marrëdhëniet mes tyre.

Furnizimi efektiv i sigurimit të burrave, grave, vajzave dhe djemve

- Derisa policia është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rendit publik dhe mbrojtjen e njerëzve, ajo ka detyrë që të kuptojë dhe të ndërmer aksione preventive dhe t'u përgjigjet formave të ndryshme të kriminalitetit dhe pasigurisë që paraqiten prej burrave, grave, vajzave dhe djemve.
- Dhuna e bazuar në gjini (DBG), duke përfshirë këtu dhunën shtëpiake, trafikimin e njerëzve dhe përdhunimeve seksuale, paraqet një nga kërcënimet më të mëdhenj të sigurisë njerëzore në botë. Oficerët policor patjetër duhet të kenë trajnim të përshtatshëm për t'u përgjigjur viktimave të DBG dhe ndjekjen ligjore dhe hetimin e këtyre krimeve në mënyrë efektive.

Shërbimi shembullor policor

- Krijimi i shërbimit shembullor policor i cili i shërben popullatës që kërkon shërbime – lidhur me etnicitetin, gjininë, religjionin, gjuhën, përkatësinë fisnore etj. – e zmadhon kredibilitetin, besueshmërinë dhe legjitimitetin e shërbimit në sytë e popullatës.
- Shërbimi shembullor policor e zmadhon efektivitetin operativ përmes ofrimit të fushës së gjërë të shkathtësive, përvojës, edukatës dhe kulturës, gjë që e maksimizon aftësinë për zgjidhje lokale të problemeve lokal².
- Gratë shpeshherë ofrojnë shkathtësi dhe fuqi specifike në punën policore, siç është qetësimi apo shtensionimi i situatave potenciale të dhunshme, që minimizon përdorimin e forcës dhe përdorimin e aftësive të mira komunikative³. Në këtë kontekst, oficerët femra janë të nevojshme për formimin e kordoneve dhe kërkimin (kontrollimin) e grave, zgjërimit e rrjetit të zbulimit (përmbledhjes së informatave) dhe asistimit të viktimave të DBG.
- Në përgjithësi, burrat tani janë në numër shumë më të madh prezent në shërbimin policor. Për këtë arsye, janë të nevojshme iniciativa specifike për zmadhimin e rekrutimit, përmbytjes dhe përparimit të personelit femëror.

Fillimisht në vitin 2008 ky dokument u botua me titull «Toolkit on Gender and Security Sector Reform» nga ana e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (ODIHR), Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe Institutit Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnim për Avancimin e Femrave (UN-INSTRAW).

Shërbimi policor që promovon të drejtat njerëzore dhe jodiskriminimin

- Eliminimi i diskriminimit dhe thyerjes së të drejtave të njeriut, siç është ngacmimi seksual dhe përdhunimi prej policisë kundër civilëve dhe bashkëpunëtorëve, do të ndihmojë krijimin e një mjedisi punues efektiv dhe produktiv.
- Qëndrimet diskriminues të personelit policor mund të parandalojë drejtimin e barabartë të shërbimeve policore. Në shumë vende, grate raportojnë se policia është e pandjeshme dhe mund të dështojë hetimin adekuat në krimet e bazuara në gjini.⁴ Politika e përgjegjshme ndaj gjinive, protokollet dhe ndërtimi i kapaciteteve mund të zmadhojë profesionalizmin e policisë dhe drejtimin ndaj shërbimeve policore.

Pajtueshmëria me obligimet ndaj ligjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

Marrja e iniciativës për integrimin e çështjes gjinore brenda reformës policore, nuk duhet bërë vetëm për efektivitetin operativ; por, është e nevojshme edhe të ketë pajtueshmëri me ligjet, instrumentet dhe normat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sigurinë dhe gjinitë, aking. Instrumentet kyç përfshijnë:

- *Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW, 1979)*
 - *Deklarata dhe platforma për aksion e Pekingut (Beijing, 1995)*
- Për informata më të hollësishme, Ju lutemi shikoni në aneksin (shtojcën) e doracakut për Ligjet dhe instrumentet ndërkombëtare.

Si mundet të integrohet gjinia në reformat policore?

Vlerësim

- Zbatoni vlerësim të përgjegjshëm gjinor, ose revizion që fokusohet specifikisht në çështjet gjinore, siç janë rekrutimi i femrave, shkalla e maltremit seksual ose përgjigjet ndaj dhunës familjare.

Politika, protokollet dhe procedurat për gjinitë

- Zhvillimi dhe implementimi i protokoleve dhe procedurave specifike të hetimit, ndjekjes penale dhe përkrahjes së viktimave të DBG.
- Formimi i sjelljes së përgjegjshme ndaj gjinive dhe politikës së diskriminimit, ngacmimit seksual dhe dhunës së bërë nga vetë policët dhe mekanizmave raportues të brendshëm të cilët mund t'i pranojnë ankesat.

- Ushtimi i rekrutëve policorë për rastet e DBG-së, përfshirë këtu edhe dhunën shtëpiake.
- Krijimi i strukturave stimuluese për caktimin e politikës përgjegjëse ndaj gjinive me respektim të të drejtave të njeriut.
- Rishikimi i strukturës operative, protokolleve dhe procedurave me:
 - Shoqata policore të femrave dhe shoqata tjera të personelit policor, të identifikojnë gjendjen momentale dhe reformat e duhura.
 - Komision policor bashkiak, organizata të shoqatave qytetare, përfshirë këtu edhe grupet e grave dhe të mbijetuarit nga dhuna, të identifikohen reformat e nevojshme dhe të sigurohet se protokollet dhe procedurat janë në pajtueshmëri me nevojat e bashkësisë.

Stacionet policor femëror / Njësitë kundër dhunës shtëpiake

- Konsideroni formimin e stacioneve policorë femëror (WPS), ose njësitë specifike lidhur me DBG për të inkurajuar sa më shumë viktimë që të lajmërojnë ankesat dhe t'i përmirësojnë përgjigjet ndaj DBG (shih Kuti 1).

Trajnimi i gjinive

- Integrimi i çështjeve të gjinive në trajnimin bazik që i jepet personelit policor, duke e përfshirë edhe stafin civil.
- Ofrim i trajnimit të detyrueshëm dhe të hollësishëm për ndjeshmërinë e gjinive dhe maltremit seksual për personelin policor në përgjithësi.
- Mundësimi i tërësishëm i trajnimit për fitimin e shkathtësive lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me gjininë, siç janë intervistimi i viktimave të trafikimit të njerëzve dhe protokolleve për të i përgjigjur dhunës shtëpiake, dhunës kundër homoseksualëve, keqpërdorimit të fëmijëve dhe përdhunimit (sulmeve seksuale).

Shembulli 1 | Stacionet Policore Femërore (WPS) në Amerikën Latine⁵

Një studim që u bë më vitin 2003 të WPS në Argjentinë, Brazil, Kolumbi, Kosta Rika, Ekuador, Nikaragua, Peru dhe Uru-guaj, demonstroi se çdo strukturë është unike dhe shërben segmente të ndryshme të popullatës, varësisht prej shtetit dhe ligjeve penale. Edhe pse ekzistojnë dallime, karakteristikat kryesore janë siç vijojnë:

- Shumica merren më dhunë familjare ndaj grave, vajzave dhe djemve.
- Shërbimet furnizohen në partneritet me punonjës shteti dhe jo-punonjës shteti.
- Shërbimet policore e bëjnë përpunimin e deklaratave, kryerjen e hetimeve, ndërmjetësimin e marrëveshjeve bashkë me punonjësit social.
- WPS policët janë ekskluzivisht femra.
- Nuk i kushton asgjë përdoruesit shfrytëzimi i shërbimeve multi-disiplinare.

Njësitë WPS synojnë të:

- Mbrojnë femrat prej kërcënimeve ndaj sigurisë së tyre.
- Mundësimin e së drejtës për shërbime juridike, ndihmë shëndetësore dhe psikologjike, që për një pjesë të përdoruesve, më së shpeshti për të varfërit, nuk janë të arritshme.
- Kontribut i përgjithshëm në fokusimin ndaj gjinive dhe sigurimit.
- Kontribuojnë për qeverisje më të mire me anë të bashkëpunimit mes levizjeve për të drejtat e femrave dhe organizatave jo-shtetërore, policisë dhe në disa raste, me udhëheqjen e mekanizmave të femrave në zonat e shërbimeve për përkudjesje, koordinim dhe administrim.
- Mbledhje të dhënash rreth hetimeve për të cilët njësitë WPS janë të përgjegjshme.

Rekrutimi, pëmbajtja dhe përparimi i personelit femëror

- Konsideroni themelimin e qendrave strategjike për rekrutimin dhe pëmbajtjen e femrave.
- Përditësoni politikën e rekrutimit në mënyrë praktike, që maksimalisht të tërheqni individ të kualifikuar, duke përfshirë grupet që janë më pak të prezantuar. (shiko Kutinë 2).
- Përditësoni përshkrimet e pozitive të punës, që në mënyrë precize t'i pasqyrojë shkathtësitë të kërkuara nga policia moderne.
- Revizioni dhe adaptoni politikën kadrovike që të siguroheni se ajo është jodiskriminuese, e ndjeshme ndaj gjinive dhe miqësore ndaj familjeve.
- Themeloni shoqata të femrave police dhe programe mentorësh.
- Rishikoni standardet e vlerësimit të punës dhe kriterieve promovuese për diskriminimin. Implementoni analiza vlerësuese në bazë të performansave.
- Siguroni akses të barabartë në trajnim për dhe përparim në karrierë.

Mbikëqyrja dhe bashkpunimi me shoqërinë qytetare

- Konsideroni politikën e bazuar në bashkësinë, si një strategji efektive për pajisje të sigurisë dhe bashkpunim me bashkësinë, duke përfaqësuar organizata joqeveritare, siç janë grupet e grave. (p.sh. trajnim dhe patrullim të përbashkët)
- Themeloni sisteme drejtuese që policia t'i udhëzojë viktimat të kontaktojnë me shërbimet shoqërore duke përfshirë edhe organizatat e grave.
- Krijoni apo përforconi mekanizmat mbikëqyrës civil, siç janë komisionet bashkiak të policisë, me qëllim që të rritet niveli i kredibilitetit dhe të formohet kanal formal komunikimi mes policisë dhe shoqërisë.
- Ndërtimi i kapacitetit të organizatave qytetare për monitorim efektiv të politikës për thyerjen e të drejtave njerëzore.

Poashtu në dispozicion në Veglën 2...

- Shablloni për planin veprues për reformën gjinore
- Shembull i marrëveshjes protokollare ndërmjet policisë dhe bashkësisë lokale.
- Ushtrueshmërisë së mire për DBG-së
- Listë e plotë e gjinive për politikën ndaj komunitetit
- Këshilla se si duhet udhëhequr vlerësimi i mjedisit punues
- Lista e plotë për formim të përshkrimit të punës
- Strategjitë për rekrutim, pëmbajtje dhe përparim të personelit femëror
- Listë e plotë për politikën e ngacmimit seksual.

Sfidat dhe mundësitë pas konfliktit

Në shtetet të cilët gjenden në periudhë pas konfliktit, shpeshherë paraqitet një nivel pasigurie, me përhapjen e disa llojeve të violencës. Shërbimet policore, nëpër këta shtete, janë afër kolapsi total, ose ju mungon legjitimiteti për shkak të pjesëmarrjes në konflikt. Ndonjëherë ka nevojë urgjente për reforma sistematike në sektorin e policisë, duke përfaqësuar parandalimin e abuzimit në bazë gjinore, pas konfliktit.

Sfidat për integrimin e çështjeve të gjinive

- Policia shpesh ka kryer krime violente, siç janë dhunimi dhe sulmet seksuale, ndaj anëtarëve të bashkësisë shoqërore, që sjell deri te niveli i madh i pabesueshmërisë. Në raste të tilla, mund të jetë shumë i vështirë rekrutimi i grave në forcat policore, ndërsa lajmërimi i abuzimit gjinor vazhdon të lëviz në shkallë të ulët.

Shembulli 2

Përkrahje edukative për femrat e rekrutuara në polici në Liberi⁶

Në Liberi, Kombet e Bashkuara dhe Qeveria e Liberisë kanë institucionalizuar Programin përkrahës edukativ për femrat rekrute potenciale, në policinë nacionale të Liberisë (LNP). Programet e përshpejtuara kanë qëllim të sjellin nivel edukativ të grave të interesuara deri në diplomimin e shkollës së mesme, kështu që ato të mund të kualifikohen për rekrutimin në LNP. Siç thot Alan Doss, kryetari i misionit të Kombeve të Bashkuara në Liberi, për programin e nisur për gratë e reja në Liberi: "Kjo është një mundësi që jo vetëm të zgjerohet edukimi juaj, por, nëse ju e kaloni me sukses këtë test, ju mundeni t'i bashkangjiteni LNP-së dhe të ndihmoni ndryshimet në shtetin tuaj, sidomos për gratë në këtë shtet."

- Për institucionet policore, organizatat e shoqërisë qytetare janë të dyshimta dhe ngurrojnë dhe nuk janë të gatshëm të punojnë me to.
- Policia nacionale shpesh punon në kushte të vështira pa pajisjet e nevojshme dhe me paga të ulëta, derisa ende janë në pritje të ndërrimit të mandateve të tyre, çështje që shpesh rezultojnë me refuzimin që proceset e reformave policore të kenë përparësi, përfshirë këtu edhe reformat për gjinitë.
- Përkushtimi për reformë policore të përgjegjshme ndaj gjinive humb, kurse krimi fillon të rritet dhe policia u kthehet mënyrave shtypëse drejt krimit duke i penguar grupet e caktuara në shoqëri.
- Forcat policore nacionale nuk janë vetëm agjentët e involvuar në polici – por edhe, kompanitë private të sigurimit, milicitë dhe persona të armatosur jashtinstitucional që duhet të inkuadrohen në orvatjet për sektorë të sigurimit të përgjegjshëm ndaj gjinive.

Mundësitë për integrimin e çështjeve të gjinive

- Kujdesi ndërkombëtar dhe përkrahja financiare mund të ndikojnë që procesi reformues të bëhet i ndjeshëm ndaj nevojave të burrave dhe grave, sidomos kur forcat policore ndërkombëtare qytetare luajnë rolin e modeleve si shembuj.
- Role të ndryshëm gjinorë dhe strukturat shoqërore sigurojnë hapësirë që më tepër gra të konsiderojnë policinë si mundësi profesionale.
- Reforma e zgjeruar e shërbimit policor siguron edhe mundësinë të përcaktimit të caqeve për rekrutimin e femrave, ushtrimin e rekrutëve dhe integrimin e çështjeve të gjinive brenda rregullave dhe protokolleve të rinj, programimin operativ dhe trajnimin.
- Kështu mund të zmadhohet numri i grave në disponim për punësim në polici – përfshirë edhe gratë amvisë dhe femrave që kanë luftuar më parë.
- Për shkak të niveleve të lartë të DBG në mjediset konfliktuoz dhe post-konfliktuoz, mund të nxitet formimi i njësive të specializuara për përballimin e dhunës kundër grave dhe fëmijëve, si në Afganistan, Liberi dhe Sierra Leone (shih Shembullin 3).

Sierra Leone kaloi nëpër konflikt i cili zgjati një dekadë, ku DBG (dhuna në bazë gjinore) u përdor si metodë luftimi. Gratë dhe vajzat ishin viktime kidnapimi, përdhunimi, keqpërdorimi, gjymtimi dhe torturimi. Përveç krimeve të luftës, një analizë që u zbatua nga HRW gjatë periudhës prej 1998, deri me vitin 2000, dëshmoi se 70% prej grave që kanë marrë pjesë në intervistën e bërë, kanë thënë se kanë qenë të rrahura nga burrat e tyre, ndërsa 50% të grave kanë qenë të detyruara të marrin pjesë në marrëdhënie seksuale. Përveç asaj që abuzimet po ndodhninçdokund, njerëzit heshtnin rreth paraqitjes së dhunës në bazë gjinore (DBG). Studimet tregojnë se 60% prej femrave të intervistuar besonin që e kanë merituar rrahjen prej partnerëve të tyre, një perceptim i gabuar që duhej sfiduar. Pasi heshtja filloi të thyej, rritej njohja se ato që kanë përjetuar abuzime, kanë nevojë për polici në afërsi, që të lajmërojnë krime të tilla, kanë nevojë për mbrojtje, strehim të përkohshëm, tretman shëndetësor dhe psikologjik., ndihmë juridike, etj. Megjithatë, qëndrimi i policisë ndaj personave që kanë përjetuar dhunë seksuale nuk ishte mbështetës, që rezultoi me atë që shumë gra mos të lajmërojnë abuzimet në polici.

Si përgjigje ndaj kësaj, Qeveria e vendosi Njësinë e parë për Mbështetje Familjare në vitin 2001. Njësi që do të merrej me sulme fizike, sulme seksuale dhe keqpërdorimin e fëmijëve. Përveç kësaj, policët filluan me trajnim se si të merren me dhunë familjare dhe dhunë seksuale.



Pyetjet për reformën policore

Një ndër metodat më të mira për identifikimin e pikave hyrëse, fuqitë dhe dobësitë e inkuadrimit të perspektivave gjinore në reformat policore, është zbatimi i vlerësimit. Më poshtë gjenden shembuj pyetjesh që janë të rëndësishme për tu futurë në vlerësimin, vëzhgimin dhe evaluimin e reformave policore

- A ekzistojnë kuadra operative, rregullore, procedura, apo mekanizma të tjera, për të udhëhequr përgjigjet e policisë ndaj abuzimit në bazë gjinore (DBG)?
- A ekzistojnë rregulla për sjellje dhe politikë të hollësishme mbi ngacmimin seksual? A janë duke u zbatuar? A është i monitoruar implementimi i tyre?
- A ka përfutur staf policor mbindërtim të kapacitetit të tyre lidhur me çështjet gjinore?

- A janë formuar mekanizma të brendshëm dhe të jashtëm për ankesa dhe a mund të gjenden lehtë? A ekziston ombudsman (mbledhës ankesash) i cili i pranon ankesat për ngacmim seksual, diksiminim ose dhunë?
- A ekzistojnë çfarëdo organe mbikëqyrës, siç janë komisione komunale të policisë? A e monitorojnë ata DBG dhe diskriminimin?
- Cili është numri dhe rangi i femrave dhe meshkujve në personelin policor?
- A ekzistojnë masa për zmadhimin e rekrutimit, përmbytjes dhe përparimit të femrave në personelin policor, si dhe grupe tjerë me numër më të vogël? A janë proceset jodiskriminues? A kanë femrat police pagesë dhe beneficione të barabarta me meshkujt?
- A mund të u drejtohen shërbimeve policore gratë dhe burrat në vendet urbane dhe rurale?
- A ekzistojnë programe ose iniciativa të politikës shoqërore?

Informata më të hollësishme

Burime

Qendra për fëmijë dhe familje në sistemin gjyqësor – *Doracak për policinë përgjigjen policore ndaj dhunës familjare: Promovimi i bashkësive më të sigurta përmes integritit të kërkimit dhe ushtrimit*, 2004.

Këshilli i Evropës – *Udhëzimi VIP: Vizioni, inovacioni dhe profesionalizmi në veprim ndaj dhunës grave dhe fëmijëve*, 2001. Qendra ndërkombëtare për reformat e ligjit penal dhe Policia gjyqësore penale.- *Strategjitë model dhe masat praktike për eliminimin e dhunës kundër grave në fushën e parandalimit të krimit dhe Drejtësia kriminale: Doracaku burimor*, 1999.

Qendra nacionale për gra dhe polici – *Rekrutimi dhe përkrahja e grave. Udhëzimi vetvlerësues për zbatimin e ligjeve*, 2001.

OECD-DAC — *OECD DAC Doracak për Reformën e sistemit të sigurimit: Mbështetja e sigurimit dhe drejtësisë*, 2007.

UNIFEM/UNDP — *Reforma e policisë për ndjeshmërinë e gjinive në situatë post-konfliktuale – kumtesës udhëzuese të veprimit*, 2007.

Organizata

Iniciativa për të drejtat e njeriut e Commonwealth-it - www.humanrightsinitiative.org

Rrjeti evropian për gra police - www.enp.nl

Shoqata ndërkombëtare e grave police - www.iawp.org

Qendra nacionale për gratë dhe policinë - www.womenandpolicing.org

Shoqëria e hapur Iniciativa juridike - www.justiceinitiative.org

OSCE – Njësia strategjike e çështjeve policore -

www.osce.org/spmu/UNIFEM - www.unifem.org

Gjinitë dhe doracaku SSR

1. Reformat në sektorin e sigurimit dhe gjinitë
2. Reforma policore dhe gjinitë
3. Reforma e mbrojtjes dhe gjinitë
4. Reforma juridike dhe gjinitë
5. Reforma penale dhe gjinitë
6. Menaxhimi i kufinjve dhe gjinitë
7. Mbikëqyrja parlamentare të sektorit të sigurimit dhe gjinitë
8. Politika nacionale e sigurimit – Formimi dhe gjinitë
9. Mbikëqyrja e shoqërisë qytetare mbi sektorin e sigurimit dhe gjinitë
10. Kompanitë private ushtarake dhe të sigurimit dhe gjinitë
11. Vlerësimi SSR, monitorimi, evaluimi dhe gjinitë
12. Trajnimi i gjinive për personelin në sektorin e sigurimit Aneks (shtojcë) për ligjet dhe instrumentet ndërkombëtarë dhe regional.

Secilin prej këtyre mjeteve dhe shënimeve praktik mund ta gjeni në: www.dcaf.ch, www.un-instraw.org and www.osce.org/odihr

Ky shënim praktik është përgatitur nga Anna Korneeva prej UN-INSTRAW, i bazuar mbi Veglën 2, autor i të cilit është Tara Denham.

¹ Groenewald, H. and Peake, G., *Police Reform through Community-Based Policing: Philosophy and Guidelines for Implementation*, (International Peace Academy: New York), 2004, p.1.

² United Kingdom Police Home Office, 'It works...The Operational Benefits of Diversity for the Police Service', 2005, p.4.

http://police.homeoffice.gov.uk/news-and-publications/publication/humanresources/Operational_Benefits_Leaflet.pdf

³ Lonsway, K. et al., *Hiring & Retaining More Women: The Advantages to Law Enforcement Agencies*, National Center for Women & Policing, 2003.

⁴ UNIFEM, *Not a Minute More: Ending Violence Against Women*, (UNIFEM: New York), 2003, p. 46.

⁵ Jubb, N. and Izumino, W.P., 'Women and Policing in Latin America: A revised Background Paper', (Latin American Studies Association: Texas), 27-29 March 2003. <http://www.nevusp.org/downloads/down085.pdf>

⁶ United Nations Mission in Liberia, 'Launching of Special Education Programme for Potential Female Recruits of Liberia National Police', Press Release Jan. 22, 2007. <http://unmil.org/article.asp?id=1951>